



Raport monitorues 13-të

mbi punën e legjislativ të komunës së
Lipjanit

Qershor 2016

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Dinamika e punës së Kuvendit,
- NOTIMI,
- TRENDI I DISKUTIMEVE,
- ÇËSHTJET E INICIUARA,
- PYETJET E PARLAMENTARE,

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan
Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>
<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International"



Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

***Youth Association for Human Rights /YAHR** që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.*

Në hartimin e këtij raporti të trembëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar-Qershor 2016. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2016, kuvendi komunal i Lipjanit ka pasur një dinamikë të mirë të aktiviteteve. Ku gjatë kësaj periudhe kemi 22 vendime të miratuara ose 71 %, 5 raporte apo njoftime të ndryshme të shqyrtuara 16% dhe 4 rregullore ose plane komunale të miratuara me 13 %.
- ✓ Kjo periudhë karakterizohet edhe me mos seriozitet të deputeteve komunal, kjo më së miri tregohet në mbledhjen e 27-të të Kuvendit Komunal të Lipjanit të mbajtur me 4 prill 2016. Ku ata si përfaqësues të qytetarëve nuk tregojnë aspak seriozitet në punën e tyre karshi të zgjedhësve të tyre. Të cilët për shkak të kohës së drekës dhe për arsye që sa më shpejtë të përfundohet mbledhja, në mënyrë të shpejtë për 15 minuta i përfundojnë tri pika të rendit të ditës, duke kaluar herë në pikën e fundit e herë në pikën në fillim të rendit të ditës. Andaj, YAHR-i kërkon nga të gjithë deputet që të tregojnë pak respekt për zgjedhësit e tyre dhe se nuk kanë nevojë që të nxitojnë për të përfunduar sa më shpejtë mbledhjet, se ju ri kujtojmë së për punën e tyre ata paguhet me mëditje nga taksat e tatimpaguesve.

- ✓ Top treshja me aktive nga ana e deputetëve të kësaj legjislature për periudhën Janar- Qershor 2016 është: **FLORENT HOXHA PDK 74 pikë , LULZIM RRUSTEMI PDK 54 pikë dhe XHEVAT OLLURI AAK-LDD-IQL 48 pikë.**
- ✓ Top 5-ta më pasive në Kuvendin Komunal për periudhën Janar- Qershor 2016 përbëhet nga deputetet: **VALBONA SHILLOVA PDK, DAUT AZEMI LDK, ARTON RETKOCERI LDK, BURBUQE FAZLIU LDK dhe EDITA GASHI VETËVENDOSJE.**
- ✓ Në mbledhjen e 27-të të Kuvendit Komunal të Lipjanit, Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni dështon në menaxhimin e mbledhjes. Sepse, që në fillim të seancës tenton që të bëjë shkelje mbi rregulloren e punës së kuvendit , duke mos e lejuar që të votohet propozimi i deputetit të AAK-së Xhevat Ollurit për të futur një pikë në rendin e ditës, ajo duke e injoruar propozimin e deputetit Olluri, tenton që vetëm propozimin e saj ta vendos në votim për rend të ditës.
- ✓ Sa i për ketë angazhimeve individuale të deputeteve me pyetjet parlamentare vazhdohet që të jenë aktiv. Ku gjatë kësaj periudhe kemi 12 pyetje drejtuar ekzekutivit dhe janë ngritur 9 çështje konkrete të problemeve që ballafaqohen qytetarët e Komunës së Lipjanit. Është interesante se të gjitha këto pyetje dhe shqetësime të deputetët e Kuvendit Komunal të Lipjanit nuk marrin përgjigje adekuatë nga ana e ekzekutivit. Ekzekutivi i komunës është i obliguar që të ju përgjigjet deputetëve në rast të parashtrimit të pyetjeve, për mos përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara nga deputet kemi të bëjë me shkelje të ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 të datës 20 shkurt 2008, të nenin 39. Ku ka të bëjë me të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit të komunës, pika 2, ku thuhet citojmë: "Anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendës-kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës". Po ashtu, kemi shkeljen e rregullores së punës të Kuvendit Komunal të Lipjanit të datës 07.11.2014, të Kapitullit VI. Ku ka të bëjë me të drejtat, obligimet e anëtarëve të Kuvendit dhe parashtrimi i propozimeve procedurale, ku në nenin 14 lidhur me të drejtat e anëtarëve të Kuvendit të komunës në pikën "e", thuhet citojmë: "" Të kërkojnë nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e organeve të Administratës Komunale, informacione me gojë dhe me shkrim lidhur me çështjet komunale".
- ✓ Gjatë kësaj periudhe raportuese të gjitha komitetet e Kuvendit Komunal të Lipjanit, me përjashtim të KPF-së janë pasive dhe nuk kemi një punë konkrete të këtyre komiteteve dhe mbledhjet që mbahen janë shumë formale.

Tabela 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura të Komiteteve

	Komitetet *informatat janë marrë nga ueb faqja e komunës: http://kk.rks-gov.net/lipjan/Njoftimet.aspx	Numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë periudhës Janar-Qershor 2016	Numri i mbledhjeve të mbajtura prej themelimit deri Qershor 2016
1	Komiteti për Politikë dhe Financa	4	22
2	Komiteti për Komunitete	2	16

3	Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm	0	11
4	Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	0
5	Komiteti për Shëndetësi	1	1
6	Komiteti për Arsim	0	4
7	Komiteti për Shërbime Publike	0	2
8	Komiteti Konsultative	0	0

- ✓ Komuna e Lipjanit vazhdon me shkeljen e Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008, me anë të Statutit Komunal (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008). Ku në bazë të këtij ligji, Komuna e Lipjanit i ka 59 vendbanime dhe fshatra, ndërsa në Statutin Komunal në kapitullin II, ku ka të bëjë me vendbanimet e komunës, gjegjësisht në nenin 13. rreth vendbanimet dhe fshatrat, figurojnë 70 vendbanime dhe fshatra, që do të thotë në bazë të ligjit të lartë përmendur Komuna e Lipjanit i ka 11 fshatra më pak se sa me statutin komunal.
- ✓ Vazhdohet me mos transparencë nga ana e Kryesueses së Kuvendit Komunal, me injorimin e dërgimit të materialeve të seancave të Kuvendit ndaj shoqërisë civile.


Rekomandimet:

- ✓ Të tregohet respekt nga ana e deputeteve për zgjedhësit e tyre dhe se nuk kanë nevojë që të nxitojnë për të përfunduar sa më shpejtë mbledhjet, se punën e tyre paguhen me mëditje
- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.
- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit

Në këtë vit 2016 deri me tani janë mbajtur katër seanca plenare të rregullta dhe një e jashtëzakonshëm, me qëllim të ri-destinimit të mjeteve buxhetor për vitin 2016. Ndërsa, janë mbajtur vetëm katër mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është një gjendje e njëjtë.

AKTIVITETET E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË LIPJANIT



Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2016:

- *Njoftim me gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit për vitin 2015*
- *Informatë për punën e KKS-së për vitin 2015.*
- *Raporti i punës i zyrës së Kryetarit dhe i Drejtorive Komunale për vitin 2015*
- *Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2015 për Komunën e Lipjanit.*
- *Raport tre mujor i shpenzimeve të buxhetit, realizimi i investimeve kapitale dhe të hyrat për periudhën Janar-mars 2016*

Lista e rregulloreve dhe planeve komunale të miratuar gjatë vitit 2016:

- *Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike*
- *Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.*
- *Rregullore për taksat komunale*
- *Rregullore për plotësimin e rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2016:

- Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2015
- Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2014 dhe 2015 në vitin 2016.
- Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparence në Komunë
- Vendim për miratimin e planit të veprimit kundër korrupsionit
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve
- Vendim për anulimin pjesërisht të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-157 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTPSH. Sadovina).
- Vendim për anulimin pjesërisht të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-159 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTP Adriatik Commerc)
- Vendim për miratimin e programit komunal trevjeçar për banim 2016-2019
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme –lokaleve afarist të Komunës në ZK. Lipjan.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK. Banullë.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK. Ribar i Vogël
- Vendim për anulimin e pjesërisht të vendimit 1Nr. 464-123 dt. 20. 06. 2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-164 te dt. 01. 08. 2006 për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme
- Vendim për anulimin e vendimit 1Nr. 464-331 te dt. 23. 10. 2003 dhe shkëputjen e kontratës 1-463-322 te dt. 04. 10. 2007 për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme
- Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për bujqësi
- Vendimi për lirimin nga pagesa e tarifave në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik në Lipjan të nënave vetë ushqyese për fëmijët e tyre.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
- Vendim për anulimin e aktvendimeve 1Nr.464-833 dt.21.10.2009, 1Nr.464-833/1 dt. 14. 04. 2010 dhe nënkontratave të datës 22. 10. 2009
- Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSb-së

- Vendimi mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitin 2015 në vitin 2016,
- Vendim për dhënies në shfrytëzim tokës pasurori shoqërore për vendosjen e trafo stacionit distributor në Lipjan,
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës së Sindikatës së Administratës Komunale.

Tabela 2: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit		
Janar – Qershor 2016		
Raporte të shqyrtuara	Rregullore dhe plane komunale të miratuara	Vendime komunale të miratuara
5	4	22

NOTIMI I PËRGRHITHËM

Kuvendi i Komunës së Lipjanit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (LDK, PDK AAK-LDD-IQL, VETËVENDOSJE, AKR, PD ,PSD dhe G.I.SRPSKA).

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendit komunal të Lipjanit. Monitoruesit e YAHR-it kanë përcjellë të gjitha seancat e kuvendit të komunës së Lipjanit gjatë periudhës Janar - Qershor 2016. Për më tepër, monitoruesit e YAHR-it kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga nëntë kategoritë e poshtëshënuara si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

YAHR-i në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në kategoritë e paraqitura në vijim:

1. Propozim për rend dite
2. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
3. Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve
4. Inicimi i çështjeve
5. Amandamentimi i legjislacionit
6. Inicimi i rregulloreve
7. Pyetjet parlamentare
8. Mungesa në seanca
9. Gjuha joparlamentare

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 20-22, në bazë të fletë-notimit për se cilin deputet:

- Vërejtje: përkatësia e politike e deputeteve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të deputeteve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh, se ka pasur lëvizje të shumta dhe nuk kemi qartësi të plotë të përkatësisë politike.

Tabela 3: Pjesëmarrja e Deputeteve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamenti i legjislacionit	Inicimi i rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
FLORENT HOXHA	PDK	2	56	1	5	0	0	10	0	0	74
PETRIT KELMENDI	PDK	0	40	0	0	0	0	0	0	0	40
LULZIM RRUSTEMI	PDK	2	36	1	10	0	0	5	0	0	54
NAZMI KRASNIQI	PDK	2	12	0	0	0	0	5	0	0	19
ENVER KOZHANI	PDK	0	12	1	10	0	0	5	0	0	28
FERIZ HASANI	PDK	0	12	1	0	0	0	5	0	0	18
ALI STUBLLA	PDK	0	16	0	0	0	0	5	-1	0	20
VALBONA SHILLOVA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
BURBUQE ILAZI	PDK	2	0	0	0	0	0	5	0	0	7
VLORA BUJA	PDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
LABINOT SHAHINI	LDK	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
NEHAT TERPEZA	LDK	0	4	1	0	0	0	0	0	0	5
DAUT AZEMI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
AGRON HAJDINI	LDK	0	24	1	0	0	0	0	0	0	25
ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NAIM JAHIRI	LDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
VLORA LIMANI-HAJNUNI	LDK	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
BURBUQE FAZLIU	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LINDA SHAHINI	LDK	0	12	1	0	0	0	5	0	0	18
XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	4	44	0	0	0	0	0	0	0	48
RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0	0	0	5	0	0	0	0	0	5
UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	2	0	0	5	0	0	5	0	0	12

HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	2	24	0	10	0	0	0	0	0	36
ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
BLERIM GASHI	AKR	0	44	1	0	0	0	0	0	0	45
ADELINA KRASNIQI	AKR	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
XHAVID MAHOLLI	PDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
RAMIZ QIRIQI	PSD	2	28	0	0	0	0	5	0	0	35
ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2016, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.

Deputetet më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: FLORENT HOXHA PDK 74 pikë, LULZIM RRUSTEMI PDK 54 pikë, XHEVAT OLLURI AAK-LDD-IQL 48 pikë, BLERIM GASHI AKR 45 pikë, PETRIT KELMENDI PDK 40 pikë, HAJRIJE SALIHU AAK-LDD-IQL 36 pikë, RAMIZ QIRIQI PSD 35 pikë, ENVER KOZHANI PDK 28 pikë, AGRON HAJDINI LDK 25 pikë, ALI STUBLLA PDK 20 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 19 pikë, FERIZ HASANI PDK 18 pikë, LINDA SHAHINI LDK 18 pikë, LABINOT SHAHINI LDK 12 pikë, MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI AAK-LDD-IQL 12 pikë, ARBEN BAHTIRI VETËVENDOSJE 12 pikë, ZORAN CIRKOVIC G.I.SRPSKA 9 pikë, VLORA BUJA PDK 8 pikë, XHAVID MAHOLLI PD 8 pikë, BURBUQE ILAZI PDK 7 pikë, NEHAT TERPEZA LDK 5 pikë, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL 5 pikë, NAIM JAHIRI LDK 4 pikë, ADELINA KRASNIQI AKR 4 pikë dhe UKË KRYEZIU AAK-LDD-IQL 1 pikë.

Deputete më pasivë të ashtuquajtur "Shikues" janë: VALBONA SHILLOVA PDK, DAUT AZEMI LDK, ARTON RETKOCERI LDK, BURBUQE FAZLIU LDK dhe EDITA GASHI VETËVENDOSJE.

Tabela 4: Renditja e deputeteve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit

Deputet aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve							
	Deputeti	Subjekti politikë	pikët		Deputeti	Subjekti politikë	pikët
1	FLORENT HOXHA	PDK	74	16	ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	12
2	LULZIM RRUSTEMI	PDK	54	17	ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	9
3	XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	48	18	VLORA BUJA	PDK	8
4	BLERIM GASHI	AKR	45	19	XHAVID MAHOLLI	PDK	8
5	PETRIT KELMENDI	PDK	40	20	BURBUQE ILAZI	PDK	7
6	HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	36	21	NEHAT TERPEZA	LDK	5
7	RAMIZ QIRIQI	PSD	35	22	RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	5


8	ENVER KOZHANI	PDK	28	23	NAIM JAHIRI	LDK	4
9	AGRON HAJDINI	LDK	25	24	ALBULENA GASHI/ ADELINA KRASNIQI	AKR	4
10	ALI STUBLLA	PDK	20	25	UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	1
11	NAZMI KRASNIQI	PDK	19	26	VALBONA SHILLOVA	PDK	0
12	FERIZ HASANI	PDK	18	27	DAUT AZEMI	LDK	0
13	LINDA SHAHINI	LDK	18	28	ARTON RETKOCERI	LDK	0
14	LABINOT SHAHINI	LDK	12	29	BURBUQE FAZLIU	LDK	0
15	MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	12	30	EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	0

Pjesëmarrja e subjekteve politike të Kuvendit në diskutime nga seanca 25-29, në bazë të fletë-notimit:


Tabela 5: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT	Propozim për rend dite		Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave				Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare			Mungesa në seanca		
Subjekti politik	Piket	%																
PDK	4	44.44	%	48	46.15	%	4	44.44	%	5	55.56	%	8	66.67	%	1	100	%
LDK	0	0	%	14	13.46	%	3	33.33	%	0	0.00	%	1	8.33	%	0	0	%
AAK-LDD-IQL	4	44.44	%	17	16.35	%	1	11.11	%	4	44.44	%	1	8.33	%	0	0	%
VV	0	0	%	3	2.88	%	0	0	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0	%
AKR	0	0	%	12	11.54	%	1	11.11	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0	%
PD	0	0	%	2	1.92	%	0	0	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0	%
PSD	1	11.11	%	7	6.73	%	0	0	%	0	0.00	%	1	8.33	%	0	0	%
G.I.SRPSKA	0	0	%	1	0.961		0	0		0	0.00		1	8.33		0	0	

Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave




Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve



PYETJET E PARLAMENTARE DHE INICIMI I ÇËSHTJEVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar - Qershor 2016, kemi vërejtur një trendë i rritjeve të pyetjeve dhe shqetësimeve drejtuar ekzekutivit të komunës së Lipjanit dhe kanë qenë për këtë periudhë gjithsej 12 pyetje dhe 9 çështje të ngritura. Subjekti i PDK-së gjatë kësaj periudhe i ka ngritur 8 çështje me 66.67 %, LDK 1 me 8.33 %, AAK-LDD-IQL 1 me 8.33 %, PSD 1 me 8.33 % dhe G.I.SRPSKA 1 ose me 8.33 %.



Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 27-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 04.04.2016:

Feriz Hasani: pyeti se kur do të ndahen shkolla e Glllogovcit.

Merita Zeqiri: pyeti se ndërtesat e banimit që lëshohen në përdorim a kontrollohen nga dikush se a i plotësojnë kushtet apo jo. Pyetja e dytë ishte lidhur me rrugën “Ramiz Shala”, gjatë punimit të ujësjellësit kjo rrugë është dëmtu dhe

askush nuk është duke e rregulluar. Pyetja e tretë ishte lidhur me lagjen e muhagjerëve në Bujari, gjatë të reshurave kemi vërshime për shkak të mbylljes së urave dhe kërkon që këto ura të hapen.

Florent Hoxha: kërkoj që Jeta e Re të futet në Statutin e Komunës e gjithashtu edhe disa fshatra që teritorialisht i takojnë Lipjanit e janë me Graçanicë. Pastaj pyeti se a është bërë ndonjë inspektim për ujin e pijes pas vërshimeve që kanë ndodhë. Në fund kërkoj që të mbyllet një gropë në rrugën “Qamil Olluri” e cila është hapur që 3 vite e që këtë e kishte kërkuar edhe më herët.

Ramiz Qeriqi: përmendi shqetësimin e punëtorëve të shtëpisë së shëndetit në Lipjan, meqë në rrugën “Tahir Sinani” gjatë ditëve të tregut parkohen automjetet ku pengohet edhe ndihma e shpejt e shtëpisë së shëndetit, andaj kërkoj që të vehen shenjat e ndalim parkimit të automjeteve në këtë rrugë. Shqetësim tjetër ishte të qytetarëve të lagjes Te Abeja, ku në oborrin e fabrikës së Letrës është bërë një grumbull i mbeturinave nga kompania e Standard Benz. Ku gjatë përpunimit të naftës apo vajit është duke kundërmua një erë e rëndë dhe kërkoj nga organet përgjegjëse që të marrin masa për këtë çështje dhe të njoftohen në mbledhjen e ardhshme. Shqetësim tjetër ishte për banorët që banojnë afër Xhamisë ku një qytetarë ka sjellë fotografitë për gjendjen që është aty.

Linda Shahini: shprehi shqetësimin për shkak të zërit të madh të kafiterive, por edhe gjithashtu edhe kioska që është afër stacionit të policisë e cila shet CD-ja ku zëri i muzikës është shumë i madh dhe krijon përshtypjen se sikur je në një darsëm.


Lulzim Rrstemi, kërkoj që në rend dite të Kuvendit të hynë edhe shqyrtimi i raporteve të komiteteve.

Burbuqe Ilazi, kërkoj që në rrugën e tranzitit që vjen në qytet të vëhet një pasqyre meqë në këtë vend është rrezik përmanent për aksidente.

Zoran Çirkoviq, komuna ka bërë ndriqimin publik në Grackë por kemi probleme për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriqimit. Te shkolla “B Aksiq” në Lipjan kërkoj që mundësisht të bëhet asfaltimi i rrugës meqë gjatë vërshimeve nxënësit kanë vështirësi nga uji të hyjnë në shkollë. Në Grackë ka ndërtime pa leje e gjithashtu ka uzurpime nga ata të cilët kanë ardhur ku kanë blerë nga 10 ari e tani me uzurpime i kanë bërë nga 30 ari dhe është mirë që në këtë drejtim të mirren masa nga organet kompetente.

Nazmi Krasniqi, muaj më parë kemi pasur vërshime në teritorin e komunës së Lipjanit meqë rast janë shkaktuar dëme dhe është mirë që si Kuvend të kemi një raport se qfarë dëme janë shkaktuar dhe ku.

Ali Stublla, përmendi një pjesë të rrugës Dobratin-Sillovi ku për 20 metra kanë mbetur pa u shtru dhe kjo pjesë e rrugës krijon përshtypjen sikur të janë dy shtete.



AMANDAMENTIMI I LIGJISLACIONIT


Rreth amandamentimit të rregulloreve të ndryshme të kuvendit komunal gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur .

MUNGESA NË SEANCA

Në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në pesë seancat e mbajtura në periudhën Janar - Qershor 2016 kemi mungesë të deputeteve në një seanca një deputet.

PROPOZIM PËR REND DITE

Është shumë interesante që krahasim me periudhat e kaluara, kësaj radhe kemi vetëm dy propozime konkrete për rende dite nga përfaqësueses nga AAK-LDD-IQL rreth çështjes së ndarjes së Shkollës së Mesme Profesionale “Adem Gllavica” dhe një kërkesë nga PDK-ja.



Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Janar - Qershor 2016,.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar - Qershor 2016,.
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Janar - Qershor 2016,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Qershor 2016.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Janar - Qershor 2016,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

